



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 10637 Prot.

Fier më 19/09/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 80 dt. 19/09/2025

Për një saktësim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Fier Nr.64, datë.23/06/2025 “Për miratimin e tabelës me të dhënat e listës emërore të pronave dhe pronarëve , që do të shpronësohen për interes publik, për pasuritë e paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për zgjerimin e sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP), vlerësim paraprak me qëllim mbulimin e vlerës paraprake të shpronësimit për interes publik nga Buxheti i Bashkisë Fier, për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik”.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë/09/2025, i paraqitet për shqyrtim materiali nga ekzekutivi I Bashkisë Fier , I cili bazuar në dokumentacionin e hartuar nga Komisioni I shpronësimit dhe vlerësimit paraprak, ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr.340 , datë 18/07/2024, në kuadër të realizimit të projektit të miratuar ” Për zgjerimin i sheshit të stacionit zjarrfikës, të ndërtuar dhe financuar nga PNUD(UNDP)”, për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrative-ligjore të kërkesës së shpronësimit për interes publik, nga subjekti kërkuar Bashkia Fier në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve , pranë MIE , Tiranë .

Nga Komisioni I shpronësimit për interes publik dhe vlerësimit paraprak është evidentuar një gabim në përlllogaritjen dhe vlerësimin paraprak të sipërfaqeve të pjesshme të llojit truall dhe ndërtesë ,në pasurinë e paluajtshme pronë private në pronësi të pronarit Kreshnik Bashkim Myrto , me nr.rendor 2 në tabelën me të dhënat e pronave dhe pronarëve që shpronësohen për interes publik dhe vlerësim paraprak miratuar me VKB Nr.64 , datë.23/06/2025 pika “1” , sipërfaqe që preken pjesërisht nga vija e shpronësimit bazuar në projektin e zbatimit të ndryshuar dhe miratuar me VKB Nr.126, datë.31.10.2024 “Për shtimin e sipërfaqes së sheshit të Stacionit Zjarrfikës .

Në zbatim të kërkesave ligjore të kërkesës së shpronësimit për interes publik , tabela sipas formatit tip , me të dhënat e pasurive dhe pronarëve private me vlerësime paraprake , duhet të saktësohet bazuar në dokumentacionin ligjor dhe teknik të hartuar dhe pasqyruar në tabelën e saktësuar bashkëlidhur këtij projektvendimi .

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma "b", Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", VKM.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik", i ndryshuar bazuar në nenin 54, gërma "k" si dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë Fier nr.139, datë 23/12/2024 " Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm PBA(2025-2027), dhe miratimin e buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025 " , i ndryshuar , ekzekutivi I Bashkisë :

Propozon :

1. Të miratojë tabelën sipas formatit tip , me saktësimet përkatëse në përlllogaritje dhe vlerësime paraprake , për pronarin privat Kreshnik Bashkim Myrto , me nr.rendor 2 , për pasurinë e paluajtshme pronë private me nr. 3/690, zk.8532, pasuri e llojit truall dhe ndërtesë e cila preket pjesërisht nga realizimi I projektit , sipas tabelës bashkëlidhur ,
2. Vlera paraprake e shpronësimit për interes publik sipas tabelës bashkëlidhur do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Fier për vitin 2025;
3. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Sektorin e Shpronësimeve , Tiranë ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Fier.

KRYETAR
Armando Subashi

NË MUNGESË ME AUTORIZIM
ZËVENDËSKRYETAR

Vasil Bregu

